



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Njoftim për shtyp
(04 shtator 2007)

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 76% të aksioneve në Albtelekom Sh.a tek Çetel S.A

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij të datës 04 shtator 2007, shqyrtoi çështjen me objekt Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të 76 % të aksioneve të shoqërisë Albtelekom Sh.A tek Çetel S.A.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të njoftimit të përqendrimit, vërejt se **Albtelekom**, shitësi i pjesës 76 % të kapitalit aksioner është shoqëri anonime me kapital 100% shtetëror, me seli në Tiranë, Shqipëri, me aksioner të vetëm METE. Albtelekom ushtron veprimtarinë sipas legjislacionit shqiptar, me një licensë shërbime publike të telekomunikacioneve për një periudhë 15-vjeçare. **Eagle Mobil, filial i Albtelekom**, shoqëri aksionare, e zotëruar plotësisht (100%) nga Albtelekom

ÇETEL A.S, është aksioneri/ blerësi i pjesës 76 % të kapitalit të paketës së vetme të përbërë nga 11.400.000 aksione në Albtelekom, me vlerë nominale për aksion 1000 Lekë, përfaqësuar nga z. Ahmet Çalik. ÇETEL është shoqëri anonime e themeluar dhe e krijuar sipas ligjeve të Republikës së Turqisë, pjesë e grupit Çalik Holding. Çalik Holding është i pranishëm në tregun bankar shqiptar, si aksionar/ zotërues i pjesës 60% të kapitalit aksionar në Bankën Kombëtare Tregtare, nëpërmjet Çalik Seker.

ÇETEL A.S nuk ka veprimtari ekonomike në Shqipëri. ÇETEL ka nënshkruar marrëveshje ortakërie dhe menaxhimi me shoqërinë Turk Telekomunikation. **Turk Telekomunikation A.S** e krijuar sipas ligjeve të Republikës së Turqisë, me qendër në Ankara, Turqi, ushtron veprimtari në fushën e telekomunikacionit si për ofrimin e shërbimit me shumicë dhe pakicë zanor. Turk Telekomunikation A.S do të asistojë ÇETEL përsa i përket manaxhimit të Albtelekomit për kryerjen e shërbimeve të telefonisë fikse dhe GSM, manaxhimit dhe vënies në funksionim të infrastrukturës së telomunikacionit për të gjitha segmentet e linjës fikse/tokësore në tregun kombëtar.

Transaksioni i realizuar nëpërmjet shitblerjes të paketës 76% të aksioneve nga Çetel S.A, përbën një përqëndrim në kuptimin e nenit 10, pika 1 shkronja a e Ligjit, si dhe përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 12, pika 1 të Ligjit.

Në tregun e shërbimeve për ofrim interneti, ADSL dhe modem, Albtelekom do të monitorohet për sjelljen në tregun e shumicës (wholesale).

Ndërsa në tregun e shërbimit me pakicë (të përdoruesit të internetit) Albtelekom zotëron 25% dhe ky treg është i hapur për konkurrencë si pasojë e numrit të licensave të dhëna dhe penetrimit të ulët të shërbimit të internetit në tregun shqiptar.

Autoriteti i Konkurrencës do të monitorojë në vazhdimësi tregun e telekomunikacioneve në dy drejtime: të strukturës, mbasi raporti i përqendrimit të tregut të telefonisë fikse është shumë i lartë, si dhe të sjelljes të ofruesve me fuqi të ndjeshme në treg për të shmangur abuzimet e mundshme me pozitën dominuese apo praktikatat e bashkërenduara që çenojnë konkurrencën, ndërmjet operatorëve aktualë dhe atyre potencialë.

Si konkluzion, transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të 76% të kapitalit aksionar në Albtelekom nga ÇETEL, dhe nuk krijon ose forcon pozitën dominuese të shoqërisë së re pas përqendrimit.

Për këto arsye, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", Komisioni i Konkurrencës vendosi të **autorizojë përqëndrimin** e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 76 % të kapitalit aksionar të Albtelekom Sh.A tek Çetel S.A, me qendër në Stamboll, Turqi.